



UDHËRRËFYESI

PËR NJË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME PËR ZOTËRIMIN E PALIGJSHËM, KEQPËRDORIMIN DHE TRAFIKIMIN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA (AVL), MUNICIONEVE TË TYRE DHE EKSPLOZIVËVE

NË BALLKANIN PERËNDIMOR, BRENDA VITIT 2030.



UDHËRRËFYESI

PËR NJË ZGJIDHJE TË QËNDRUESHME PËR ZOTËRIMIN E PALIGJSHËM, KEQPËRDORIMIN DHE TRAFIKIMIN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA (AVL), MUNICIONEVE TË TYRE DHE EKSPLOZIVËVE

NË BALLKANIN PERËNDIMOR, BREDA VITIT 2030.

PËRKTHIM JOZYRTAR

Udhërrëfyesi për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e AVL-ve dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor, brenda vitit 2024 u hartua në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet përkatëse të rajonit, nën kujdesin e Republikës Federale të Gjermanisë dhe me mbështetjen teknike të SEESAC¹, si dhe nën koordinimin e Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Bashkimit Evropian.

Udhërrëfyesi u hartua në vijim të shprehjes së angazhimit të qartë politik nga të gjithë aktorët në rajon për fuqizimin e masave të kontrollit të armëve dhe mospërhapjes së tyre, angazhim i cili u konfirmua përmes miratimit të një **Deklarate të Përbashkët** në takimin rajonal të nivelit të lartë të Zëvendësministrave të Brendshëm dhe Zëvendësministrave të Punëve të Jashtme, të mbajtur më 1 shkurt 2018 në Podgoricë, Mal të Zi. Dokumenti u miratua zyrtarisht më 10 korrik 2018, në Samitin e Londrës të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, çka tregoi gatishmërinë e fortë të juridiksioneve për të përballuar sfidën e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor dhe në mbarë Evropën.

Siç është konfirmuar nga konkluzionet e Vlerësimit Afatmesëm, të përfunduar në fillim të vitit 2023, zbatimi i Udhërrëfyesit ka qenë një sukses. Vlerësimi afatmesëm konfirmoi, ndër të tjera, rëndësinë e Udhërrëfyesit në të gjitha aspektet e kontrollit të AVL-ve dhe ndikimin e rëndësishëm të tij në koordinimin dhe bashkëpunimin në nivel rajonal.² Në përputhje me një nga rekomandimet kyçe të Vlerësimit Afatmesëm, autoritetet në rajon gjatë Takimit të nivelit të lartë të BE-së për luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit në Evropën Juglindore, të mbajtur në maj 2023, në Bruksel, shprehën dakordësinë dhe angazhimin e tyre për të vazhduar zbatimin e Udhërrëfyesit përtej vitit 2024. Gjithashtu, BE dhe Ballkani Perëndimor rikonfirmuan në Forumit Ministror për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme të mbajtur më 26-27 tetor 2023, në Shkup, “vendosmërinë e tyre për të eliminuar trafikimin dhe përhapjen e armëve të vogla dhe të lehta dhe risollën në vëmendje marrëveshjen e arritur në maj 2023 për zgjatjen e periudhës së zbatimit të Udhërrëfyesit për kontrollin gjithëpërfshirës të armëve të vogla dhe të lehta përtej vitit 2024”. Për më

1 SEESAC koordinon veprimtaritë të lidhura me kontrollin e armëve dhe luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit, bazuar në “Planin Rajonal të Zbatimit për luftën kundër përhapjes së armëve të vogla dhe të lehta në Evropën Juglindore”, Deklaratën e Përbashkët për përmirësimin e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit dhe municioneve në Ballkanin Perëndimor, e cila u miratua në Forumit Ministror mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme të mbajtur më 16 dhjetor 2016 si dhe Konkluzionet e Kryetarëve nga Takimi i nivelit të lartë për luftën kundër trafikimit të armëve të zjarrit në Evropën Juglindore në kuadër të zbatimit të veprimeve specifike për Evropën Juglindore të parashikuara në “2020-2025 Plani i Veprimit të BE-së për trafikimin e armëve të zjarrit”, që përfshin dhe zbatimin e Udhërrëfyesit për kontrollin gjithëpërfshirës të armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor më 16 maj 2023.

2 Krahas kësaj, në Raportin e vitit 2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për armët e vogla dhe të lehta janë përgëzuar autoritetet e Ballkanit Perëndimor për progresin e konsiderueshëm të bërë në zbatimin e Udhërrëfyesit. Raporti nënvizon ndikimin e konsiderueshëm të udhërrëfyesve rajonalë, duke e vënë veçanërisht theksin tek Udhërrëfyesi i Ballkanit Perëndimor.

tepër, sipas Deklaratës së Samitit mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, datë 13 dhjetor 2023, “Udhërrëfyesi, zbatimi i të cilit u zgjat përtej vitit 2024, është një shembull i njohur në nivel ndërkombëtar i praktikës së mirë të bashkëpunimit rajonal për forcimin e kontrollit të armëve të vogla.”

Në vijim të marrëveshjes, në vitin 2023 dhe 2024 u organizuan takime konsultative në mbarë rajonin me Komisionet e Armëve të Vogla dhe të Lehta për të rishikuar tekstin e Udhërrëfyesit, duke garantuar kështu angazhimin në nivel rajonal dhe qëndrueshmërinë e rezultateve. Me qëllimin për të ruajtur qasjen gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrjen e gjerë në këtë proces, konsultimet përfshinë donatorët, partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Më 9-10 korrik 2024, autoritetet e Ballkanit Perëndimor u takuan në Podgoricë, në Takimin e 11-të rajonal të koordinimit të Udhërrëfyesit dhe konsoliduan tekstin përfundimtar të rishikuar të Udhërrëfyesit. Udhërrëfyeti për zbatim në vitet 2025-2030 u aprovua në Forumin Ministror të BE-Ballkanit Perëndimor për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme të mbajtur në Budva, në 28 Tetor 2024.



Zbatimi i Udhërrëfyesit do të lehtësojë më tej përpjekjet e Ballkanit Perëndimor në përmbushjen e kushteve kryesore të sigurisë për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian, siç parashtrohet në Komunikatën e KE-së **“Një perspektivë e besueshme zgjerimi dhe rritje e angazhimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor”**, në Planin e Veprimit bashkëngjitur këtij dokumenti, me titull **Mbështetje për transformimin e Ballkanit Perëndimor, në Strategjinë e BE-së të vitit 2018 kundër armëve të paligjshme të zjarrit, armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre – Sigurimi i armëve, mbrojtja e qytetarëve**,³ si dhe në **Planin e Veprimit të BE-së mbi trafikimin e armëve të zjarrit 2020-2025**.⁴ Për më tepër, Udhërrëfyesi do të kontribuojë drejtpërdrejt në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 16 dhe 5, veçanërisht të synimit 16.4, i cili ka për qëllim uljen në mënyrë të konsiderueshme të flukseve të paligjshme financiare dhe të armëve, brenda vitit 2030.

Ky dokument përbën gjithashtu një instrument për matjen e progresit, si dhe një udhëzues për një mbështetje të koordinuar dhe sinergjike në këtë fushë në rajon, çka mundëson shfrytëzimin e fondeve të donatorëve në mënyrë efektive dhe efikase. Udhërrëfyesi vihet në zbatim përmes planeve të veprimit, të cilat integrohen dhe mbështesin strategjitë egzistuese për AVL-të përmes objektivave të matshëm dhe treguesve konkretë që përdoren për të matur progresin në nivel kombëtar dhe rajonal.

Qëllimi i Udhërrëfyesit është të vazhdojë të shërbejë si një dokument udhëzues dhe konsensual i përgatitur dhe në pronësi të autoriteteve rajonale, për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme kundër zotërimit të paligjshëm, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve në Ballkanin Perëndimor. Ky dokument është një dëshmi e konsensusit të arritur ndërmjet të gjitha palëve në rajon lidhur me sfidat aktuale, synimet e përgjithshme për t'u arritur dhe afatit kohor të masave për t'u ndërmarrë. Udhërrëfyesi ofron një platformë të përgjithshme për nivelet e performancës të miratuara bashkërisht, si dhe parashton angazhimin e nevojshëm në nivel strategjik, politik dhe operacional, duke u mbështetur në angazhimin politik kundrejt Programit të Veprimit të OKB-së “Për parandalimin, luftën dhe eliminimin e tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta në të gjitha aspektet”, Traktatit për Tregtinë e Armëve, si dhe në detyrimeve që rrjedhin nga Protokolli kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit, Pjesëve të tyre, Komponentëve dhe Municioneve (Protokolli i OKB-së për Armët e Zjarrit).

Zbatimi me sukses i Udhërrëfyesit do të vazhdojë të kërkojë përpjekjet e bashkërenduara të autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe mbështetjen e përqendruar, të koordinuar dhe në kohë të donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë.

³ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=JOIN:2018:017:FIN>

⁴ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52020DC0608&from=nl>

VIZIONI I UDHËRRËFYESIT:

Ballkani Perëndimor është një rajon më i sigurtë dhe një eksportues i sigurisë, me mekanizma gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian dhe standardet e tjera ndërkombëtare, për të parandaluar, identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve.



OBJEKTIVAT E UDHËRRËFYESIT 2025-2030

OBJEKTIVI 1

Brenda vitit 2030, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe i standardizuar në të gjithë rajonin.

OBJEKTIVI 2

Brenda vitit 2030, të garantohen politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor, të cilat janë të bazuara në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës.

OBJEKTIVI 3

Brenda vitit 2030, të ulet në mënyrë të konsiderueshme keqpërdorimi si dhe prodhimi, zotërimi dhe qarkullimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve (AME).

OBJEKTIVI 4

Brenda vitit 2030, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa, zotërimi i paligjshëm dhe keqpërdorimi i armëve, municioneve dhe eksplozivëve nëpërmjet masave parandaluese.

OBJEKTIVI 5

Brenda vitit 2030, të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit përmes rritjes së mbrojtjes dhe sigurisë së stoqeve si dhe asgjësimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.

Udhërrëfyeni i kushton rëndësi të veçantë përmirësimit të barazisë gjinore. Rrjedhimisht, ky dokument është hartuar mbi bazën e një analize gjinore të kontrollit të AVL-ve/armëve të zjarrit në rajon⁵ dhe përforcon rekomandimet kryesore të saj⁶. Krahas kësaj, përfaqesuesit gra dhe burra kanë dhënë kontribut të barabartë në hartimin dhe rishikimin e Udhërrëfyetit. Integrimi i perspektivës gjinore dhe zbatimi i saj nëpërmjet planeve të veprimit do të monitorohet me kujdes dhe do të vlerësohet si një element kyç për arritjen e rezultateve më të mira, më të qëndrueshme dhe më efikase. Progresi i zbatimit të Udhërrëfyetit do të vlerësohet nëpërmjet një Vlerësimi Afat-Mesëm në 2027, me një fokus të veçantë në Objektivin 1.

5 SEESAC (2016) Gjinia dhe AVL-të në Evropën Juglindore, shihni: http://www.seesac.org/f/docs/Armed-Violence/Gender_and_SALW_publication_eng-web.pdf.

6 SEESAC (2016) Një instrument praktik për integrimin e perspektivës gjinore në kuadrot ligjorë dhe të politikave për AVL-të, shihni: http://www.seesac.org/f/docs/Gender-and-Security/Gender_and_SALW_Toolkit_eng.pdf.

TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS

Zbatimi i Udhërrëfyesit do të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht kundrejt treguesve kryesorë të performancës (KPI) në vijim:

1. Niveli i harmonizimit apo pajtueshmërisë së kuadrit ligjor për kontrollin e armëve me kuadrin rregullator të BE-së, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit.
2. Niveli i pajtueshmërisë së strategjive/planeve të veprimit për AVL-të, të cilat janë të bazuara në statistika dhe me përgjegjshmëri gjinore, me Udhërrëfyesin.
3. Niveli i përgjigjes së agjencive ligjzbatuese si dhe shërbimit të prokurorisë dhe gjykatave ndaj incidenteve/ngjarjeve me armë, municione dhe eksplozivë (AME).
4. Numri i rasteve dhe sasia e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të kapura në territorin e brendshëm krahasuar me numrin e rasteve dhe sasinë e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të kapura në kufi.
5. Numri i rasteve të raportuara dhe i sasisë së armëve, municioneve dhe eksplozivëve të kapura në kufijtë e Bashkimit Evropian dhe me prejardhje nga Ballkani Perëndimor, si dhe numri i rasteve të raportuara dhe i sasisë së tyre të kapura brenda Bashkimit Evropian dhe me prejardhje nga Ballkani Perëndimor.
6. Numri i licencave të eksportit nga të cilat cilat armët dhe municionet janë identifikuar si të devijuara përmes procedurës së kontrollit pas dërgesave.
7. Numri i Njësive Qendrore për Armët e Zjarrit që janë të ngritura dhe funksionale.

8. Niveli i bashkëpunimit operacional në luftën kundër krimeve me armë zjarri ndërmjet autoriteteve në rajon, Shteteve Anëtare të BE-së dhe agjencive ndërkombëtare.
9. Numri i incidenteve që përfshijnë armë dhe eksplozivë, si dhe numri i viktimave nga këto incidente, i ndarë sipas gjinisë dhe moshës.
10. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve të dorëzuara vullnetarisht, si dhe i armëve të zjarrit të legalizuara ose të çaktivizuara.
11. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve (të konfiskuara, të dorëzuara vullnetarisht ose tepricë) të raportuar sistematikisht të shkatërruara.
12. Numri i armëve, municioneve dhe eksplozivëve që zotërohen nga 1) institucionet, 2) subjektet juridike private dhe 3) civilët të raportuara si të humbura ose të vjedhura.
13. Përqindja e qytetarëve që ndihen të kërcënuar nga zotërimi i paligjshëm dhe keqpërdorimi i armëve.

1. KUADRI LEGJISLATIV DHE RREGULLATOR PËR KONTROLLIN E ARMËVE DHE STANDARDIZIMI I TIJ

Kontrolli i qëndrueshëm i armëve kërkon politika, procedura dhe praktika menaxhimi që zbatohen në nivel global, rajonal dhe kombëtar. Ky kontroll përfshin aktorë ndërkombëtarë, kombëtarë, tregtarë, të sigurisë, joqeveritarë dhe të tjerë që operojnë sipas kushteve të përcaktuara me kujdes dhe të ndërvarura. Ndaj, një kuadër i fortë legjislativ në pajtim me kuadrot, standardet dhe udhëzimet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, përbën një objektivi gjithëpërfshirës dhe prioritar për të gjitha përpjekjet.

Egziston një nevojë e qartë që kuadri legjislativ dhe rregullator në Ballkanin Perëndimor të harmonizohet edhe më tej me kuadrin rregullator të BE-së dhe të jetë në përputhje me Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit, në mënyrë që të lehtësojë përgjigjen ndaj kërcënimeve të rëndësishme dhe të reja. Në kuadër të këtij objektivi, arritja e synimeve të përgjithshme të parashikuara do të mbështetet në rezultatet e fazës së parë të Udhërrëfyesit, çka do të kontribuojë rrjedhimisht në pajtueshmërinë e ligjeve dhe procedurave ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në standardizimin e mëtjshëm të procedurave dhe praktikave për kontrollin e armëve.

Masat e parashikuara do të mbështeten në standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare në fushën e kontrollit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve që do të garantojnë koordinimin e parandalimit, zbutje dhe përgjigje, si dhe konsistencë, përputhshmëri maksimale, ndërveprim dhe cilësi.



OBJEKTIVI 1. Brenda vitit 2030, të garantohet miratimi i legjislacionit për kontrollin e armëve, i harmonizuar me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare dhe i standardizuar në të gjithë rajonin (KPI 1).

Synimet e përgjithshme	Referenca aktuale	Afati kohor
<p>Të plotësohet dhe të rishikohet rregullisht kuadri ligjor për të rregulluar prodhimin, blerjen dhe mbajtjen për përdorim civil, si dhe për të luftuar trafikimin dhe keqpërdorimin e armëve dhe municioneve, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera përkatëse ndërkombëtare.</p>	<p>Të gjitha juridiksionet kanë ligj për armët, por ai nuk është i harmonizuar ende me Direktivën e BE-së 2021/555 “Për armët e zjarrit”, Direktivën Zbatuese 2019/68 “Për markimin e armëve të zjarrit” (ndryshuar nga Direktiva Zbatuese 2024/325) dhe Direktivën Zbatuese 2019/69 “Për armët për alarm dhe sinjalizim”, si dhe me Rregulloren “Për zbatimin e nenit 10 të Protokollit të OKB-së për Armët e Zjarrit” dhe Rregulloren 2015/2403 “Për çaktivizimin” të ndryshuar nga Rregullorja 2018/337.</p> <p>Në shumicën e juridiksioneve miratimi i legjislacionit dytësor në mbështetje të legjislacionit parësor është i vonuar.</p> <p>Janë kryer vlerësime të detajuara mbi nivelin e harmonizimit të kuadrit ligjor me legjislacionin e BE-së dhe Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit në të gjitha juridiksionet. Në disa juridiksione, vazhdojnë përpjekjet në kuadër të harmonizimit me dispozitat e kriminalizimit të Protokollit të OKB-së për Armët e Zjarrit dhe në disa prej tyre është konstatuar progres i dukshëm. Ndër to, janë 3 juridiksione në të cilat është arritur një harmonizim gjithëpërfshirës.</p>	<p>2025-2030</p>

<p>Të plotësohet dhe të rishikohet rregullisht kuadri ligjor për të rregulluar prodhimin dhe mbajtjen për përdorim civil, si dhe për të luftuar trafikimin dhe keqpërdorimin e eksplozivëve (duke përfshirë artikujt piroteknike) dhe prekursorëve e eksplozivëve, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së.</p>	<p>Të gjitha jurisdiksonet kanë ligje për përdorimin civil të eksplozivëve dhe artikujve piroteknikë, por në shumicën e tyre ato nuk janë harmonizuar ende me Kuadrin përkatës Rregullator të BE-së (Direktiva 2014/28, Direktiva 2013/29, Direktiva 2014/58 dhe Direktiva 2008/43).</p> <p>Në shumicën e jurisdikcioneve nuk është miratuar ende le-gjislacioni dytësor në mbështetje të atij parësor.</p> <p>Në asnjë prej jurisdikcioneve nuk janë miratuar ligjet për prekursorët e eksplozivëve të harmonizuara me Rregulloren e BE-së 2019/1148.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të plotësohet dhe të rishikohet rregullisht kuadri ligjor për të rregulluar prodhimin dhe tregtimin, si dhe për të luftuar tregtinë e paligjshme të armëve, municioneve, mallrave me përdorim të dyfishtë dhe pajisjeve ushtarake, në përputhje me kuadrin rregullator të BE-së dhe detyrimet e tjera përkatëse ndërkombëtare.</p>	<p>Të gjitha jurisdiksonet kanë ligje për prodhimin dhe tregtinë e armëve, municioneve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë dhe ato janë gjerësisht të harmonizuara me Qëndrimin e Përbashkët të BE-së 2008/944, Rregulloren 2021/821 të ndryshuar nga Rregullorja 2023/2616, Traktatin për Tregtinë e Armëve dhe Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së të përditësuar.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të garantohet përputhshmëria dhe standardizimi i kuadrove përkatës ligjorë për kontrollin e armëve, municioneve dhe eksplozivëve në të gjithë Ballkanin Perëndimor.</p>	<p>Përkufizimet dhe kategorizimet e armëve, municioneve dhe eksplozivëve në projektligjet përkatëse janë përgjithësisht të standardizuara në të gjithë rajonin; Disa jurisdikcione po bëjnë ndryshime në Kodet Penale, në përputhje me Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit, si dhe po asistohen për të realizuar procesin e standardizimit.</p>	<p>2030</p>
<p>Shkëmbimi i rregullt i praktikave të mira me fokus konkret në harmonizimin e kuadrit ligjor me kuadrin rregullator të BE-së dhe me detyrimet e tjera ndërkombëtare.</p>	<p>Vijon shkëmbimi i informacionit dhe praktikave të mira brenda rajonit, me BE-në dhe shtetet anëtare të BE-së, rreth harmonizimit me kuadrin rregullator të BE-së dhe me detyrimet e tjera ndërkombëtare.</p>	<p>2025-2030</p>

2. POLITIKAT E BAZUARA NË STATISTIKA DHE ME PËRGJEGJSHMËRI GJINORE, REGJISTRIMI, MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE RAPORTIMI

Po bëhet gjithnjë e më e dukshme nevoja për politika që i përgjigjen një realiteti në ndryshim, për të trajtuar sfida të reja dhe të vjetra në kontrollin e armëve, siç janë për shembull teknologjitë e reja me mënyra e funksionim gjithnjë në ndryshim, si edhe mjediset dinamike sociale, politike dhe të sigurisë. Këto politika duhet të bazohen në një kuadër të shëndoshë dhe gjithëpërfshirës për të zbatuar me efikasitet dhe efektivitet masat e kërkuara të kontrollit. Për t'iu përgjigjur kërcënimeve egzistuese dhe të reja, duhet të aftësohen vazhdimisht aktorët rajonalë që të shfrytëzojnë plotësisht burimet egzistuese, të identifikojnë mangësitë dhe të përcaktojnë sinkroninë potenciale që do të mundësonte një rregullim, menaxhim dhe zbatim më të mirë të detyrave nga të gjithë aktorët e ndryshëm të përfshirë.

Nevoja për një paketë informacioni të saktë dhe të përditësuar për të gjitha aspektet që mbulojnë kontrollin e armëve tashmë është përcaktuar si prioritet nga disa qeveri në rajon. Një Sondazh Rajonal për AVL-të që u zbatua në vitin 2018 zbuloi se praktikrat e institucioneve për grumbullimin e të dhënave janë jokonsistente, të pastandardizuara dhe shpesh mungon niveli i nevojshëm i hollësive, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndarjen e të dhënave sipas moshës dhe gjinisë. Shpesh nuk ka koordinim ndërmjet institucioneve, gjë e cila bëhet pengesë për zhvillimin e një perspektive sektoriale dhe politikave të përshtatshme të bazuara në statistika. Arritja e synimeve të përgjithshme të përfshira në këtë objektiv do të vazhdojë të garantojë politika të bazuara në statistika që shërbejnë si një bazë e shëndoshë për një përgjigje efektive dhe efikase ndaj kërcënimeve të AVL-ve/armëve të zjarrit. Në përpjekje për të garantuar një politikëbërje që plotëson kërkesat gjinore, do të vazhdohet t'i kushtohet vëmendje e veçantë faktit që mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe moshës të bëhet një praktikë rutinë në të gjithë rajonin dhe që të realizohet rregullisht një analizë gjinore gjithëpërfshirëse që informon vlerësimin dhe operacionet.

Për më tepër, grumbullimi më i mirë i të dhënave, ndarja dhe analiza e tyre do të bëjë të mundur që vlerësimet e duhura analitike të përkthehen në njohuri. për menaxhimin e rreziqeve në luftën kundër trafikimit të paligjshëm dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit duke kontribuar kështu në një qasje politikash të bazuara në informacionet e inteligjencës.

Në përfundim, të dhënat e detajuara që do të grumbullohen do të ndikojnë në raportimin në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE (raportet e progresit, track record, etj.), në marrëveshjet ndërkombëtare (të OKB-së, OSBE-së dhe instrumente të tjera), si dhe në zbatimin e Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 16.

OBJEKTIVI 2. Brenda vitit 2030, të garantohen politikat dhe praktikat për kontrollin e armëve në Ballkanin Perëndimor, të cilat janë të bazuara në statistika dhe udhëhiqen nga informacionet e inteligjencës (KPI-të 2 dhe 3).

Synimet e përgjithshme	Referenca aktuale	Afati kohor
<p>Të zhvillohen/harmonizohen strategjitë dhe/ose planet e veprimit për AVL-të me Udhërrëfyesin.</p>	<p>Në shumicën e juridiksioneve ekzistojnë strategji dhe plane veprimi për AVL-të në përputhje me Udhërrëfyesin. Angazhim i pamjaftueshëm i institucioneve përkatëse qeveritare dhe i aktorëve të shoqërisë civile në politikëbërjen për kontrollin e AVL-ve.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Integrim i plotë i çështjeve për gjininë dhe moshën në politikat për kontrollin e armëve dhe priorizimi i pjesëmarrjes reale të grave në politikëbërje.</p>	<p>Është arritur progres i konsiderueshëm në integrimin e perspektivës gjinore në strategjitë dhe planet e veprimit për kontrollin e armëve, të cilat parashikojnë një grup masash gjithëpërfshirëse për trajtimin e aspekteve gjinore të kërkesës, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë sfida në operacionalizimin dhe zbatimin e këtyre angazhimeve. Ka përfunduar analiza e integrimit të aspekteve gjinore në kuadrot ligjorë dhe të politikave për kontrollin e armëve. Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje mbetet shqetësim dhe vazhdojnë të ekzistojnë mangësi në përgjigjen institucionale. Nuk janë trajtuar mjaftueshëm lidhjet ndërmjet normave të burrërisë dhe kërkesës, përdorimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në kontrollin e armëve, veçanërisht në aspektet operacionale dhe teknike. Po ashtu, organizatat e grave dhe organizatat e shoqërisë civile që promovojnë barazinë gjinore nuk janë mjaftueshëm të përfshira në politikëbërjen për kontrollin e armëve.</p>	<p>2025-2030</p>

<p>Të monitorohen dhe vlerësohen rregullisht dokumentet e politikave për kontrollin e armëve.</p>	<p>Takimet lokale të koordinimit organizohen rregullisht, duke garantuar kështu monitorimin e zbatimit të strategjive për kontrollin e AVL-ve; Vlerësimi i dokumenteve të politikave nuk kryhet në mënyrë sistematike.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të standardizohet dhe institucionalizohet mbajtja e regjistrave dhe grumbullimi i të dhënave për armët, municionet dhe eksplozivët, të ndara sipas gjinise dhe moshës.</p>	<p>Praktikat për grumbullimin e të dhënave nuk janë të formalizuara apo të standardizuara dhe përdoren në mënyrë sporadike për të ndikuar në zhvillimin e politikave. Praktikakt aktuale të mbajtjes së regjistrave dhe të grumbullimit të të dhënave nuk pasqyrojnë kompleksitetin e rreziqeve, kërcënimeve dhe aspekteve të lidhura me armët, municionet dhe eksplozivët. Në përgjithësi, mbledhja e të dhënave për AME-të nuk është e automatizuar, si dhe ka koordinim të pamjaftueshëm midis institucioneve dhe mungesë të burimeve njerëzore të përshtatshme, çka pengon zhvillimin e politikave të bazuara në statistika; Shpeshherë, statistikak e lidhura me aspektet gjinore nuk mblidhen në kuadër të praktikave të zakonshme për mbledhjen e të dhënave.</p>	<p>2028</p>
<p>Të forcohen funksionet e planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të Komisioneve për AVL-të, për të garantuar politikave efektive për kontrollin e AVL-ve.</p>	<p>Në të gjitha juridiksionet janë ngritur Komisionet e AVL-ve, si organe koordinimi dhe monitorimi me një mandat më të fuqizuar në planifikimin, monitorimin, koordinimin dhe raportimin e aktiviteteve për kontrollin e AVL-ve, të përcaktuar në dokumentet kombëtare të politikave; Duhet të përmirësohet më tej në disa juridiksione koordinimi në nivel institucional dhe ndërinstitucional; Organizatat e shoqërisë civile nuk janë plotësisht të integruara në proceset e zhvillimit të politikave për kontrollin e armëve.</p>	<p>2025-2030</p>

<p>Të fuqizohet dhe sistematizohet mbledhja dhe raportimi i të dhënave të drejtësisë penale.</p>	<p>Ekzistojnë metodologji të ndryshme për mbledhjen e të dhënave; Nuk mund të merren të dhëna të krahasueshme në Sektorin e Drejtësisë Penale.</p>	<p>2028</p>
<p>Të garantohet gjurmimi i çdo arme të mbledhur ose të kapur (në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar).</p>	<p>Gjurmimi i armëve është sporadik dhe i paformalizuar; PSV-të për gjurmimin nuk janë miratuar ende dhe nuk janë zbatuar në FFP. Analiza e gjurmimit të armëve është gjithashtu sporadike dhe metodologjia nuk është e standardizuar.</p> <p>Të gjitha forcat policore kanë akses në Sistemin për Menaxhimin e Regjistrimit dhe Gjurmimit të Armëve të Paligjshme (iARMS) të INTERPOL dhe SIENA të EUROPOL.</p>	<p>2025-2030</p>

3. LUFTA KUNDËR PRODHIMIT DHE ZOTËRIMIT TË PALIGJSHËM, KEQPËRDORIMIT DHE TREGTISË SË PALIGJSHME TË ARMËVE, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE

Shkëmbimi i inteligjencës operacionale dhe strategjike do të çojë në parandalimin dhe zbutjen sistematike të kërcënimeve të lidhura me armët e zjarrit, në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Shqyrtimi horizontal, i cili është një ekzaminim sistematik i informacionit për të identifikuar kërcënimet dhe rreziqet e mundshme, çështjet dhe mundësitë e reja, do të mundësojë rritjen e gatishmërisë, si dhe përfshirjen e konceptit të zbutjes dhe shfrytëzimin e të dhënave dhe informacioneve me rëndësi në procesin e politikëbërjes, duke e bërë këtë një qasje të qëndrueshme.


Qasja gjithëpërfshirëse ndaj luftës kundër tregtisë dhe qarkullimit të paligjshëm të armëve, komponentëve kryesorë, municioneve dhe eksplozivëve në këtë rajon përforcohet nga disa faktorë, nga të cilët një nga kërkesat kryesore është përforcimi i kontrollit ndërkufitar dhe gjurmimi sistematik i armëve të zjarrit të mbledhura. Kontrolli kufitar efektiv shërben jo vetëm si faktor parandalues për krimin në të gjitha format e tij, por edhe si një masë që rrit besimin. Kontrolli kufitar efektiv dhe i rreptë, i shoqëruar me hetimin në kohën e duhur, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale me armë zjarri, është një parakusht për çdo program afatgjatë për sigurinë vendore dhe rajonale.

Mbi 95% e të gjitha armëve prodhohen në mënyrë të ligjshme, por shumë prej tyre devijojnë më pas drejt përdorimit të paligjshëm dhe kjo është një sfidë kyçe e cila kërkon kontroll, monitorim dhe parandalim të përforcuar nëpërmjet mekanizmave, kapaciteteve dhe procedurave të përmirësuara të kontrollit dhe masave për transparencë.

Përpjekjet e përgjithshme për reforma në sektorin e sigurisë dhe projektet mbështetëse për ngritjen e kapaciteteve, të cilat vazhdojnë në secilin prej përfituesve, kanë bërë përparime të konsiderueshme në kapacitetet e kontrollit kufitar. Ndërkohë që përpjekjet e ndërmarra deri më sot po menaxhojnë tranzicionin e përgjithshëm drejt një zbatimi më efektiv, më të përgjegjshëm dhe më efikas të ligjit, vazhdon të ekzistojë

nevoja për të ofruar asistencë të përqendruar që do të rriste profesionalizimin e aktorëve në rajon në mënyrë që të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesorë të tyre, municioneve dhe eksplozivëve. Nivelet egzistuese të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve ndërkufitare do të përfitojnë një asistencë të mëtejshme të përqendruar dhe të përshtatur sipas nevojave.

Udhërrëfyesi do të udhëzojë institucionet në rajon që të përparojnë më tej në zbatimin e kuadrove të tyre ligjore dhe të përdorin burimet teknologjike, njerëzore dhe burimet e tjera për një kontroll ndërkufitar, ndërsektorial të përmirësuar dhe të përforcuar për të luftuar trafikimin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesorë dhe municioneve të tyre dhe eksplozivëve. Ky dokument do të punojë në mbështetje të plotë të Ciklit të Politikave të BE-së kundër krimeve të rënda dhe kimit të organizuar ndërkombëtar, konkretisht të Planeve Operacionale të Veprimit të EMPACT - ARMËT E ZJARRIT.



OBJEKTIVI 3. Brenda vitit 2030, të ulet në mënyrë të konsiderueshme keqpërdorimi si dhe prodhimi, zotërimi dhe qarkullimi i paligjshëm i armëve, municioneve dhe eksplozivëve (KPI-të 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8).

Synimet e përgjithshme	Referenca aktuale	Afati kohor
<p>Të forcohen thelbësisht sistemet e analizës së rrezikut, kontrolli, monitorimi dhe parandalimi i devijimit të tregtisë së ligjshme nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve, procedurave dhe transparencës.</p>	<p>Janë ngritur mekanizma kontrolli dhe sisteme të analizës së rrezikut për armët konvencionale, por jo për prekursorët; Janë ngritur mekanizmat kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë të monitorimit; Sfida me verifikimet pas dërgesave; Nuk ka akses në bazën e të dhënave COARM. Nuk është dhënë anëtarësim në Marrëveshjen Wassenaar.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të parandalohet dhe të luftohet trafikimi, keqpërdorimi, si dhe prodhimi dhe mbajtja e paligjshme e armëve, municioneve dhe eksplozivëve përmes përmirësimit të procedurave, pajisjeve dhe trajnimit të autoriteteve të synuara ligjzbatuese dhe subjekteve të drejtësisë penale.</p>	<p>Në të gjithë rajonin përdoren metodologjitë e analizës së rrezikut dhe SOCTA (sipas modeleve të FRONTEX dhe EUROPOL) dhe shqyrtimi horizontal është zbatuar përmes SEEFEN; Në të gjitha juridiksionet ekzistojnë PSV për Policinë Kriminale, CSI-në, FFP-të, Policinë Kufitare, Doganat dhe shërbimet postare. Laboratorët e balistikës janë të akredituar sipas standardit ISO 17025 në pothuajse të gjitha juridiksionet. Në përgjithësi, janë përmirësuar kapacitetet dhe aftësitë e shërbimeve të Policisë Kufitare dhe të Policisë Kriminale, si dhe të Doganave, përmes prokurimit të pajisjeve të specializuara dhe njërive të qenve K9. Shërbimet e Policisë Kufitare dhe të Policisë Kriminale janë trajnuar për zbulimin, analizën e rrezikut, luftën kundër trafikimit dhe keqpërdorimit të armëve të zjarrit dhe situatat e emergjencës.</p> <p>Perqindje e lartë e ndërrimit të personelit të specializuar; Në të gjitha juridiksionet vazhdon të mungojë integrimi i moduleve për AME-të në kurrikulën ligjzbatuese. Asnjë njësi e CSI-së nuk është akredituar ende sipas standardit 17020. Në disa juridiksione, laboratorët e kriminalistikës kanë kapacitete të pamjaftueshme për të ekzaminuar eksplozivët dhe artikujt piroteknike, si dhe prekursorët e eksplozivëve.</p>	<p>2025-2030</p>

	<p>Kapacitetet e njësive të krimit kibernetik, për sa i përket hetimeve të lidhura me armët e zjarrit, nuk janë mjaftueshëm të zhvilluara për t'iu përgjigjur kërcënimeve të reja. Në shumicën e jurisdiksioneve kryhen hetime të kufizuara lidhur me armët e raportuara të humbura ose të vjedhura; Perspektiva gjinore nuk është ende plotësisht e integruar në procedurat e zakonshme dhe veprimtaritë e përditshme të lidhura me hetimet e AME-ve.</p> <p>Në shumicën e jurisdiksioneve, Njësitë Qendrore për Armët e Zjarrit nuk janë plotësisht operacionale.</p> <p>Praktikë gjyqësore e paharmonizuar për sa i përket dënimit të veprave penale të lidhura me armët e zjarrit, municionet dhe eksplozivët në nivel kombëtar dhe rajonal (Veprat penale të lidhura me AME-të kualifikohen kryesisht si zotërim i paligjshëm në vend që të mblidhen prova përkatëse dhe të pranueshme për ngritjen e çështjeve të suksesshme të trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit); Njohuri të kufizuara të specializuara dhe kapacitete të kufizuara teknologjike të sistemit të drejtësisë për të përpunuar në mënyrë efektive krimet e trafikimit të armëve të zjarrit.</p> <p>Nivel më i ulët i zbulimit të armëve të zjarrit në kufij krahësuar me territorin e brendshëm të vendeve; Raportimi i kërcënimeve të identifikuar në disa jurisdiksione lidhur me trafikimin e AME-ve të paligjshme brenda pakove postare, përmes dërgesave të shpejta postare dhe transportit në rrugë tokësore të pakove pa pronar; Në disa jurisdiksione është raportuar rritje e kërcënimeve të lidhura me praninë e armëve të zjarrit në rrugët e kontrabandimit të emigrantëve; Ballkani Perëndimor është vend destinacioni dhe rrugë transiti për armët me fishekë manovër (blank firing). Në kuadër të KPI 5, nuk ka statistika për armët e zjarrit të kapura brenda shteteve anëtare të BE-së, me origjinë nga Ballkani Perëndimor, për të monitoruar më mirë qarkullimin e tyre.</p>	<p>2025-2030</p>
--	---	-------------------------

<p>Të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel operacional lidhur me ndarjen e inteligjencës, duke përfshirë dhënien e informacioneve sistematike dhe në kohën e duhur.</p>	<p>Shkëmbimi i inteligjencës ndërmjet njërive dhe institucioneve të ndryshme nuk është në nivel të përshtatshëm dhe e formalizuar. Përgjigjet e marra mbi raportet dhe veprimet e inteligjencës janë sporadike dhe jo uniforme.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të forcohen mekanizmat dhe platformat e bashkëpunimit bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar, për të luftuar keqpërdorimin, prodhimin, mbajtjen dhe trafikimin e paligjshëm të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.</p>	<p>Shumica e juridiksioneve shkëmbejnë rregullisht informacion në mënyrë bilaterale, si dhe me EUROPOL, INTERPOL, FRONTEX, EUROJUST dhe aktorët e tjerë përkatës. Të gjitha juridiksionet marrin pjesë në veprimet operationale bilaterale dhe ndërkombëtare të udhëhequra nga EUROPOL, INTERPOL, EMPACT dhe FRONTEX. Të gjitha juridiksionet marrin pjesë rregullisht në rrjetet rajonale të SEEFEN, Policisë Kufitare dhe Doganave, Policisë Kriminale, FFP-ve, si dhe në Rrjetin e Prokurorëve në Ballkanin Perëndimor.</p>	<p>2025-2030</p>

4. NDËRGJEGJËSIMI, EDUKIMI, LEGALIZIMI, DORËZIMI VULLNETAR DHE ÇAKTIVIZIMI

Vlerësohet se, sipas raportimeve, një numër i lartë armësh mbahen ende në mënyrë të paligjshme nga qytetarët në Ballkanin Perëndimor. Në duart e gabuara, ato kanë potencial destabilizues dhe efektet e tyre negative mund të shumëfishohen. Si të tilla, ato paraqesin një rrezik të vazhduar për komunitetet, shoqëritë dhe institucionet. Vazhdojnë të regjistrohen raste të shumta të vetëvrasjeve me armë dhe keqpërdorimit të armëve në rastet e dhunës me bazë gjinore. Analiza e ndikimit të armëve të zjarrit kryhet vetëm në mënyrë sporadike.

Në zbatim të këtij Objektiv, Udhërrëfyesi përcakton synime të projektuara për të trajtuar tensionet shoqërore, çështjet e besimit dhe një sërë sfidash që lidhen me njohuritë, qëndrimin dhe sjelljen, ku përfshihen institucionet shtetërore, subjektet private, komunitetet dhe individët. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të përgjigjes në trajtimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore.

Për më tepër, grumbullimi i armëve, municioneve dhe eksplozivëve është një nga masat e kontrollit dhe një ndër veprimtaritë më komplekse pasi kërkon bashkëpunim të fortë ndërmjet disa institucioneve, si dhe të fitohet besimi i komunitetit/shoqërisë së synuar. Fushatat e grumbullimit tashmë të zbatuara në rajon kanë treguar se në mënyrë që dorëzimi vullnetar dhe/ose legalizimi i armëve të zjarrit të jetë i suksesshëm, duhet të bëhet një planifikim i përshtatshëm dhe ndërinstitutional që të përforcojë besimin tek institucionet e sigurisë.

Në këtë kontekst, ky objektiv synon uljen në mënyrë të konsiderueshme të armëve të zjarrit në zotërim të paligjshëm përmes dorëzimit të tyre vullnetar, si dhe përmes përdorimit të masave të legalizimit dhe çaktivizimit për të reduktuar zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit. Këto aspekte, kur kombinohen siç duhet, mund të ulin ndikimin social, ekonomik dhe mjedisor të zotërimit dhe përhapjes së pakontrolluar të AME-ve në një juridiksion të caktuar dhe në rajon.

OBJEKTIVI 4. Brenda vitit 2030, të ulet në mënyrë të konsiderueshme oferta, kërkesa, zotërimi i paligjshëm dhe keqpërdorimi i armëve, municioneve dhe eksplozivëve nëpërmjet masave parandaluese (KPI-të 9, 10 dhe 13).

Synimet e përgjithshme	Referenca aktuale	Afati kohor
<p>Të rritet ndërgjegjësimi i subjekteve të licencuara private dhe juridike (ku përfshihen prodhuesit e armëve, municioneve dhe eksplozivëve, ndërmjetësit, tregtarët, shoqëritë e transportit, koleksionuesit) për rrezikun e keqpërdorimit, përhapjes së paligjshme dhe devijimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve.</p>	<p>Niveli i papërshtatshëm i ndërgjegjësimit dhe përputhshmërisë në poligonet/shoqatat e qitjes dhe gjuetisë, dyqanet e shitjes me pakicë, shoqëritë e sigurisë; nivel i përmirësuar i informacionit në institucione, në veçanti për trafikimin nëpërmjet dërgesave të shpejta/postare dhe portaleve në internet; nivel i ulët informacioni në shoqëritë e transportit dhe shërbimet e dërgesave për rrezikun e trafikimit. Janë zhvilluar programet e brendshme të përputhshmërisë për artikujt me përdorim të dyfishtë dhe ato ushtarakë dhe këto programe udhëhiqen nga autoritetet përkatëse të licencimit. Mungesë e njohurive nga subjektet juridike dhe inspektorët lidhur me standardet e harmonizuara për prodhimin e eksplozivëve, prekursorëve të eksplozivëve dhe kategorizimin e artikujve piroteknike.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të forcohet besimi i publikut tek institucionet e sigurisë dhe të zhvillohen partneritete të qëndrueshme për të rritur advokimin dhe informimin.</p>	<p>Numri i lartë i armëve të zjarrit të shkurtra të regjistruara justifikohet kryesisht me arsyen e vetëmbrojtjes; Sipas anketës “Barometer 2023” të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, 45% e qytetarëve janë përgjigjur se ndihen të kërcënuar nga mbajtja e paligjshme dhe keqpërdorimi i armëve; Informimi i komunitetit realizohet në mënyrë sporadike; Angazhim i kufizuar i komisioneve parlamentare në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve; përfshirje sporadike dhe nivel i pamjaftueshëm ndërgjegjësimi i shoqërisë civile dhe subjekteve përkatëse juridike; nivel i ulët i partneritetit me prodhuesit për teknologjitë inovative. Publiku informohet rregullisht rreth AME-ve të kapura dhe rasteve/incidenteve me armë zjarri.</p>	<p>2025-2030</p>

<p>Të rritet ndërgjegjësimi dhe edukimi i popullsisë së përgjithshme, rreth rrezikut të AME-ve.</p>	<p>Mungesa e një metodologjie të besueshme për vlerësimin e numrit të armëve të zjarrit të paligjshme në të gjithë rajonin; Në disa juridiksione ekziston një përqindje e lartë e vetëvrasjeve me armë zjarri krahasuar me vetëvrasjet në forma të tjera; Nivel i kufizuar ndërgjegjësimi rreth mbështetjes së nevojshme për viktimat e dhunës me armë; Është krijuar një Task Forcë rajonale për ndërgjegjësimin, e cila fokusohet në masat e integruara të ndërgjegjësimin, ku përfshihet roli i medias. Në disa juridiksione janë organizuar ose janë planifikuar fushata të synuara ndërgjegjësimi dhe seanca edukimi.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të rritet ndërgjegjësimi me qëllim reduktimin e keqpërdorimit të armëve të zjarrit në dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhunën në familje dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhe të rritet ndërgjegjësimi i djemve të rinj mbi rreziqet e keqpërdorimit të armëve dhe eksplozivëve dhe angazhimi i tyre përmes programeve të synuara.</p>	<p>Është rritur ndjeshëm ndërgjegjësimi i vendimmarrësve, profesionistëve përkatës dhe medias lidhur me keqpërdorimin e gjerë të armëve të zjarrit në dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.</p> <p>Djemtë e rinj vazhdojnë të përfaqësojnë përqindjen më të lartë të autorëve dhe të viktimave të dhunës me armë. Kërkesa për armë zjarri është më e lartë nga djemtë e rinj. Djemtë e rinj janë të ekspozuar në mënyrë joproporcionale ndaj dhunës me armë.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Rritja e ndërgjegjësimin rreth rreziqeve që i kanosen publikut nga të shtënat me armë gjatë festimeve.</p>	<p>Numër i lartë i plagosjeve, si dhe i dëmeve materiale të shkaktuara nga të shtënat me armë zjarri gjatë festimeve; numër i ulët i rasteve të ndjekura penalisht/të gjykuara dhe dënime te buta.</p>	<p>2025-2030</p>

<p>Të rritet partneriteti me median dhe ndërgjegjësimi i saj për rëndësinë e raportimit të përshatshëm për keqpërdorimin e armëve të zjarrit dhe dhunës së shkaktuar nga armët e zjarrit.</p>	<p>Disa media raportojnë në mënyrë inkohente dhe dashamirëse për keqpërdorimin e armëve të zjarrit, kryesisht në kontekstin e “kulturës së armëve”, “armët e zjarrit si pjesë e traditës” etj.; Reagim i ulët institucional ndaj raportimit dhe ndjekjes së rasteve nga media.</p> <p>Është forcuar partneriteti ndërmjet gazetarëve nga rajoni dhe përfaqësuesve të ministrive të brendshme/shërbimeve policore në raportimin e dhunës me bazë gjinore; janë në proces zhvillimi udhëzimet për raportimin e incidenteve me armë zjarri.</p>	<p>2025-2027</p>
<p>Të përdoret në mënyrë sistematike legalizimi i armëve të zjarrit dhe dorëzimi vullnetar i armëve, municioneve dhe eksplozivëve, si mjet për të reduktuar zotërimin e paligjshëm dhe keqpërdorimin.</p>	<p>Në disa juridiksione, legalizimi është përdorur në mënyrë sporadike; Në disa juridiksione mundësohen periudha të gjata ri-regjistrimi pas ndryshimeve të ligjeve.</p> <p>Në disa juridiksione mungon legjislacioni që mundëson dorëzimin vullnetar të AME-ve të zotëruara në mënyrë të paligjshme, duke përfshirë dhe mundësinë e reagimit në kohë për shkak të një ngjarjeje të ndodhur.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të përdoret sistematikisht çaktivizimi për të reduktuar zotërimin e paligjshëm të armëve të zjarrit.</p>	<p>Në disa juridiksione ekzistojnë rregullore për çaktivizimin. Kapacitete jo konsistente zbatimi dhe verifikimi për çaktivizimin.</p>	<p>2025-2030</p>

5. SHKATËRRIMI FIZIK SISTEMATIK DHE MENAXHIMI I STOQEVE TË ARMËVE, MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE

Prania e vazhdueshme e sasisë së tepërt dhe AME-ve të paligjshme shërben në mënyrë të pashmangshme si faktor destabilizues në rajon dhe ekziston gjithnjë rreziku i tregtisë së paligjshme. Verifikimi i menjëhershëm dhe sistematik dhe shkatërrimi fizik i sasisë së tepërt të armëve, municioneve dhe eksplozivëve të konfiskuara është një veprimtari kyçe për ndalimin e përhapjes (d.m.th. ulja e rrezikut nga oferta në tregun e paligjshëm). Udhërrëfyesi dhe synimet e tij të përgjithshme për arritjen e këtij objekti, kanë për qëllim të garantojnë uljen e stoqeve nëpërmjet shkatërrimit sistematik dhe fizik të sasisë së tepërt të AME-ve të mbledhura ose të konfiskuara.



Menaxhimi i stoqeve është një term i gjerë që përfshin, ndër të tjera, administrimin dhe menaxhimin e stoqeve, përveç zonave teknike specifike të sigurisë së stoqeve. Nëse nuk menaxhohen siç duhet, stoqet e AME-ve mund të përhapen, të përkeqësohen, të dëmtohen ose të krijojnë një rrezik të qenësishëm për sigurinë nëse nuk magazinohen, trajtohen dhe transportohen siç duhet. Arritja e synimeve të përgjithshme për përmbushjen e këtij objekti do të garantojë që autoritetet e Ballkanit Perëndimor të kryejnë menaxhimin e stoqeve në përputhje me standardet dhe praktikat e mira ndërkombëtare, duke garantuar kështu që autoritetet kombëtare kanë kapacitet të kryejnë, monitorojnë dhe zbatojnë menaxhimin e stoqeve gjatë gjithë ciklit të jetës së AME-ve në lidhje me përgjegjësitë më të mëdha të menaxhimit.

OBJEKTIVI 5. Brenda vitit 2030, të ulet në mënyrë të konsiderueshme rreziku i përhapjes dhe devijimit përmes rritjes së mbrojtjes dhe sigurisë së stoqeve si dhe asgjësimit të armëve, municioneve dhe eksplozivëve (KPI-të 11 dhe 12).

Synimet e përgjithshme	Referenca aktuale	Afati kohor
<p>Të ulet në mënyrë sistematike teprica e AVL-ve, municioneve dhe eksplozivëve përmes shkatërrimit të tyre në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin dhe përmes metodave të tjera.</p>	<p>Ekzistojnë PSV për shkatërrimin, të cilat përfshijnë aspektin e ndikimit mjedisor; Është kryer shkatërrimi periodik i armëve; Shumica e juridiksioneve kanë poligone/mjedise ushtarake të autorizuara për shkatërrimin e municioneve; Në disa juridiksione mungon menaxhimi i ciklit të jetës (LCM) për municionet; Të paktën një juridiksion zotëron teprica të konsiderueshme municionesh.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të shkatërrohen në mënyrë të rregullt dhe të sigurt, ose të asgjësohen në një tjetër mënyrë transparente, AVL-të, municionet dhe eksplozivët e konfiskuar dhe të mbledhur.</p>	<p>Ekzistojnë PSV për shkatërrimin; Shkatërrimi periodik i armëve (sipas rastit) kryhet pas konfiskimit të tyre, ne vijim të një vendimi të formës së prerë të gjykatës si dhe pas përfundimit të procedurave përkatëse administrative të lidhura me armën, ose pas fushatave të dorëzimit vullnetar; Shumica e juridiksioneve kanë mjedise të autorizuara për shkatërrim.</p>	<p>2025-2030</p>
<p>Të forcohen kapacitetet e institucioneve përkatëse të juridiksioneve për të zbatuar menaxhimin e ciklit të jetës të AVL-ve dhe municioneve.</p>	<p>Forcat e armatosura kanë plane inspektimi me standarde të ndryshme; në disa juridiksione janë përgatitur LCM, por nuk janë të standardizuara; perqindje e lartë e ndërrimit dhe largimit të personelit të specializuar; kapacitete të kufizuara për edukimin dhe trajnimin.</p>	<p>2025-2028</p>

<p>Të garantohen mjedise magazinimi të sigurta për AVL-të, municionet dhe eksplozivët, sipas nevojave të identifikuara dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare.</p>	<p>Nivele te ndryshme sigurie në mjediset për magazinimin e AVL-ve, municioneve dhe eksplozivëve (si në forcat e armatosura po ashtu dhe në institucionet ligjzbatuese) në të gjithë rajonin; Në disa jurisdiksione është realizuar analiza kosto-përfitim për mjediset e magazinimit të AVL-ve, municioneve dhe eksplozivëve.</p>	<p>2025-2028</p>
<p>Forcimi i kapaciteteve të institucioneve për të monitoruar, mbikëqyrur dhe vlerësuar stoqet e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të subjekteve juridike dhe individëve.</p>	<p>Burimet njerëzore dhe kapacitetet administrative të subjekteve juridike (dyqanet e riparimit, dyqanet e shitjes me pakicë, poligonet e qitjes, poligonet e gjuetisë, shoqëritë private të sigurisë, qendrat e trajnimit dhe individët, si p.sh., koleksionistët) për të ndërtuar dhe zbatuar sistemet e inspektimit të brendshëm për përdorimin dhe ruajtjen e armëve, municioneve dhe eksplozivëve, janë përgjithësisht të ulëta. Ka një numër minimal njerëzish nga autoritetet kompetente dhe trajnim të pamjaftueshëm për inspektimin.</p>	<p>2025-2028</p>

ANEKS - LISTË E PËRKUFIZIMEVE

Për qëllime të këtij dokumenti dhe te raportimit sipas Indikatorëve Kryesorë te Performancës do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. **“Armë të vogla dhe të lehta (AVL)”** janë të gjitha armët vdekjeprurëse e transportueshme nga njeriu, të cilat realizojnë, janë projektuar për të realizuar ose që mund të konvertohen lehtësisht për të realizuar të shtënë me plumb ose predhë, përmes veprimit të një lënde plasëse, me përjashtim të armëve të vogla dhe të lehta antike ose imitimeve të tyre.

2. **“Armë zjarri”** është çdo armë e transportueshme, me tytë, që realizon, është projektuar për të realizuar ose që mund të konvertohet për të realizuar të shtënë me plumb ose predhë nëpërmjet veprimit të lëndës djegëse shtytëse, përveç rastit kur përjashtohet nga ky përkufizim për një nga arsyet e renditura në legjislacionin e brendshëm.

Një objekt konsiderohet i konvertueshëm për të realizuar shkrepje, për të shtyrë plumb ose predhë nëpërmjet veprimit të lëndës djegëse shtytëse kur:

(a) ka pamjen e një arme zjarri; dhe

(b) mund të konvertohet si rezultat i konstruksionit ose materialit nga i cili prodhuar.

Burimi: Direktiva (BE) 2021/555 “Për armët e zjarrit” (Përkufizim i vlefshëm për KPI 1 dhe 10)

3. **“Armë”**, për qëllime të Udhërrëfyesit, janë të gjithë artikujt që përfshihen në ligjet përkatëse për armët në Ballkanin Perëndimor. Këtu përfshihen, të paktën, armët e zjarrit për përdorim ushtarak dhe civil, armët e zjarrit të çaktivizuara, armët pneumatike, armët për alarm dhe sinjalizim (në përputhje me përkufizimet e Direktivës (BE) 2021/555 “Për armët e zjarrit”), me përjashtim të armëve të ftohta.

(Përkufizim i vlefshëm për KPIs 3, 4, 5, 9, 10, 11 dhe 12)

4. **Armë - "Armë konvencionale"** janë armë në përputhje me përkufizimin e armëve, të cilat nuk janë "armë të shkatërrimit në masë", nuk përfshihen në kategorinë e armëve kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore dhe, për qëllime të Udhërrëfyesit, përfshijnë artikujt ushtarakë në përputhje me Listën e Përbashkët Ushtarakë të BE-së.

(Përkufizim i vlefshëm për KPIs 1 dhe 6)

Burimi: Traktati për Tregtinë e Armëve.

5. **"Armët e zjarrit antike dhe imitimet e tyre"** përkufizohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Megjithatë, armët e zjarrit antike nuk përfshijnë, në asnjë rast, armët e zjarrit të prodhuara pas vitit 1899.

6. **"Artikuj ushtarakë"** janë mallrat dhe teknologjitë e klasifikuara si mallra ushtarakë nëse janë projektuar specifikisht për përdorim ushtarak.

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 1)

7. **"Mallra me përdorim të dyfishtë"** janë mallrat, softuerët dhe teknologjitë që mund të përdoren për qëllime civile dhe ushtarakë, të përkrahura në shtojcën I të Rregullores (BE) 2021/821, "Për ngritjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksporteve, të brokerimit, të asistencës teknike, transferimit dhe transitit të artikujve me përdorim të dyfishtë" (reformulim), të ndryshuar nga Rregullorja 2023/2616.

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 1)

8. **“Eksplozivë”** janë materialet dhe artikujt që konsiderohen si eksplozivë në rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave të rrezikshme dhe të cilat bëjnë pjesë në Kategorinë 1 të këtyre rekomandimeve.

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 3, 4, 5, 9, 10, 11 dhe 12)

Burimi: Direktiva (BE) 2014/28

9. **“Eksplozivë për përdorim civil”** janë materialet dhe artikujt që konsiderohen si eksplozivë në rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për transportin e mallrave të rrezikshme, të synuara për përdorim civil, me përjashtim të:

- eksplozivëve, duke përfshirë municionet, e synuara për përdorim nga forcat e armatosura ose policia, në përputhje me legjislacionin e brendshëm;
- artikujve piroteknikë që bëjnë pjesë në objektin e Direktivës 2013/29/BE dhe të ligjit përkatës;
- municioneve

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 1)

Burimi: Direktiva (BE) 2014/28

10. **“Artikull piroteknik”** është çdo artikull që përmban lëndë plasëse ose një përzierje shpërthyes substancash të projektuara për të prodhuar nxehtësi, dritë, tingull, gaz ose tym, ose një kombinim të këtyre efekteve, përmes reaksioneve kimike të pavarura ekzotermike;

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 1)

Burimi: Direktiva (BE) 2013/29

11. **“Prekursorë të eksplozivëve”** janë substancat kimike që mund të përdoren për qëllime të ligjshme, por të cilat mund të keqpërdoren gjithashtu për prodhimin e eksplozivëve artizanale.

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 1)

12. Në varësi të kërkesave të raportimit për KPI-të, do të përdoren dy përkufizime të termit **“Municion”**:

(a) **“Municion”** janë fishekët (fishekë të plotë) të armëve të vogla dhe të lehta, plumbat ose predhat që përdoren në një armë zjarri.

(Përkufizim i vlefshëm për KPIs 3, 4, 5, 6 dhe 11)

(b) **“Municion”** janë fishekët (fishekë të plotë) të armëve të vogla dhe të lehta, plumbat ose predhat që përdoren në një armë zjarri. KËTU NUK PËRFSHIHEN predhat shpërthyes, granatat dhe raketat për armë të lehta dhe kontejnerët portativë me raketa ose predha për sistemet kundërajrore dhe kundërtank.

(Përkufizim i vlefshëm për KPIs 10 dhe 12)

13. **“Trafikimi i armëve të zjarrit”** është importi, eksporti, blerja, shitja, shpërndarja, lëvizja ose transferimi i armëve të zjarrit, i pjesëve, dhe komponentëve të tyre, si dhe i municioneve nga ose përmes territorit të një shteti palë në territorin e një tjetër shteti palë në Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit nëse ndonjë nga këto shtete nuk e autorizon atë në përputhje me kushtet e Protokollit të OKB-së për Armët e Zjarrit ose nëse armët e zjarrit nuk janë markuar në përputhje me nenin 8 të Protokollit të OKB-së për Armët e Zjarrit.

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 3)

14. **“Prodhim i paligjshëm”** është prodhimi ose montimi i armëve të zjarrit, pjesëve dhe komponentëve të tyre, ose municioneve:
- i. Nga pjesë dhe komponentë të trafikuar në mënyrë të paligjshme;
 - ii. Pa licencë ose autorizim nga një autoritet kompetent i shtetit palë në Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit, ku realizohet prodhimi ose montimi; ose
 - iii. Pa i markuar armët e zjarrit në kohën e prodhimit, në përputhje me nenin 8 të Protokollit të OKB-së për Armët e Zjarrit.

(Përkufizim i vlefshëm për KPI 3)

Burimi: Protokollin e OKB-së për Armët e Zjarrit



ROADMAP

FOR A SUSTAINABLE SOLUTION TO THE ILLEGAL POSSESSION, MISUSE
AND TRAFFICKING OF SALW, THEIR AMMUNITION AND EXPLOSIVES

IN THE WESTERN BALKANS BY 2030

UNDP SEESAC
Bulevar Zorana Đinđića 64, 11070 Belgrade, Serbia
seesac@undp.org
Office: +381 (11) 4155 300
www.seesac.org